



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 14476 Prot

Vlorë, më 19.09 2024

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ . 2024

PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 92, DATË 24.11.2023 "PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA – 2024" I NDRYSHUAR

Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b të Kreut III, neni 64 pika c të Kreut X, VKM nr. 503 datë 01.08.2024 "Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të këshillit të ministrave, "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", VKB nr. 100 datë 29.12.2023, "Për miratimin Buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2024" i ndryshuar, dhe VKB nr. 92, datë 24.11.2023 "Për miratimin e numrit të punonjësve të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë dhe Funksioneve të deleguara – 2024" i ndryshuar;

VENDOSI:

1. Miratimin e klasës dhe shtesës për pozicion të pagës për punonjësit e Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë si më poshtë:

Administrata e Bashkisë Vlorë

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Kryetar		290,000
Zv/Kryetar		225,000
Këshilltar	II-2	141,000
Drejtor Kabineti	I-5	170,000
Sekretar Këshilli	I-5	170,000
Sekretar kryetari/Specialist	IV-4	60,000
Adm Rajoni	III-3	98,000
Administrator NJ.A		155,000
Drejtor i Përgjithshëm	I-5	170,000

Drejtor Drejtorie	II-2	141,000
K/Inspektor	III-2	105,000
Përgjegjës	III-2	105,000
Specialist	IV-2	80,000
Specialist	IV-3	70,000
Inspektor	IV-2	80,000
Përgjegjës	III-3	98,000
Specialist IT	IV-2	80,000 +7,500

Çerdhet	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	III-3	98,000
Kujdestar	IV-4	60,000

Konvikti (Arsimi profesional)	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	III-3	98,000
Ekonomist	IV-3	70,000
Punonjës edukativ	IV-3	70,000

Qendra e Shërbimeve me Bazë Komunitare për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	141,000
Psikolog	IV-3	70,000
Punonjës Social	IV-3	70,000
Edukatore	IV-4	60,000
Logoped	IV-3	70,000
Fizioterapist	IV-3	70,000

Bordi i Kullimit

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	III-3	98,000
Specialist	IV-3	70,000

Qendra e Kulturës

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	141,000
Përgjegjës	III-3	98,000
Punonjës	IV-3	70,000
Punonjës	IV-4	60,000

Teatri Petro Marko

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	141,000
Përgjegjës	III-3	98,000
Punonjës	IV-3	70,000
Punonjës	IV-4	60,000

Klubi Shumësportësh "Flamurtari"

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	141,000
Financier	III-3	98,000
Specialist	IV-3	70,000
Inspektor	IV-4	60,000

Qendra e Zhvillimit PAK

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Kujdestare/Edukatore	IV-4	60,000
Infermier/Logoped	IV-3	70,000

Ndërmarrja Publike për Menaxhimin e Mbetjeve Urbane

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Drejtor	II-2	141,000
Përgjegjës	III-3	98,000
Specialist	IV-2	80,000
Specialist	IV-3	70,000
Specialist	IV-4	60,000

Pyjet dhe Kullotat

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	III-3	98,000
Specialist	IV-3	70,000

Qendra e Shërbimeve Mbështetëse Për Fëmijën dhe Familjen

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Përgjegjës	III-3	98,000
Psikolog	IV-3	70,000
Punonjës Social	IV-3	70,000
Kujdestare	IV-4	60,000

Ndërmarrja e Shërbimeve Publike

Pozicioni	Klasa	Shtesa për pozicion
Dirjtor	II-2	141,000
Nëndrejtor	III-2	105,000
Përgjegjës	III-3	98,000
Specialist	IV-3	70,000
Specialist	IV-4	60,000

2. Miratimin e shtesës për vjetërsi në punë në masën:
 - i. 0,6% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
 - ii. 0,8% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
 - iii. 1% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit.
3. Fondi i pagës për këtë rritje do të pasqyrohet në Buxhetin e Bashkisë Vlorë 2024, me ndryshime.
4. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi fillojnë prej datës 1 Shtator 2024.
5. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
6. Ky Vendim hyn në fuqi sipas Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 55, pika 6.

Konceptoi: L. Brinja

K. Mali

Konfirmoi: O. Durolli

D. Demiri

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 14476 prot.

Vlorë, më 19.09 2024

RELACION

PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR DISA NDRYSHIME NË VKB NR. 92, DATË 24.11.2023
“PËR MIRATIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE DHE NIVELIT TË PAGAVE TË
BASHKISË, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË DHE FUNKSIONEVE TË DELEGUARA
– 2024” I NDRYSHUAR”

Të nderuar këshilltarë,

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9, pika 1.1.b, të Kreut III, neni 54 pika ç dhe dh, Kreu IX, neni 64, pika a, b, c, ç dhe d të Kreut X, është kompetencë e Këshillit Bashkiak miratimi i numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe institucioneve të varësisë dhe i nivelit të pagave dhe shpërblimeve të punonjësve dhe të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në lidhje me projekt vendimin e paraqitur në këtë mbledhje të Këshillit Bashkiak, ju informojmë se:

Për pikën 1. Miratimi i klasës dhe shtesës për pozicion të pagës për punonjësit e Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë.

Në VKM-në nr. 503 datë 01.08.2024 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 328, datë 31.5.2023, të këshillit të ministrave, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, ndryshohet emërtesa e klasave dhe kufijtë minimal dhe maksimal të pagës për pozicion.

Tabela nr. 1 pasqyron ndryshimet e klasave dhe shtesës për pozicionet:

- Paga e Kryetarit, Zv/Kryetarit, lidhja nr. 1, pika b, e VKM-së
- Paga e Drejtorit të kabinetit, Sekretarit të Këshillit Bashkiak dhe Këshilltarit Kryetarit të Bashkisë sipas pikës 3/d dhe pikës 3/dh/i, e VKM-së
- Paga e Administratorit të Njësive Administrative lidhja nr. 8 pika 2 e VKM-së

Tabela nr. 1

Pozicioni	Klasa e pagës (ishte)	Klasa e pagës (bëhet)	Shtesa për pozicion (ishte)	Shtesa për pozicion (bëhet)
Kryetar			185,000	290,000
Zv/Kryetar			160,000	225,000
Këshilltar	IIIA/1	II-2	73,900	141,000
Drejtor Kabineti	IIB	I-5	91,000	170,000
Sekretar Këshilli	IIB	I-5	91,000	170,000
Sekretar kryetari	IVB	IV-4	44,000	60,000
Administrator NJA			95,000	155,000

Tabela nr. 2 pasqyron ndryshimet e klasave dhe shtesës për pozicionet sipas lidhjes nr. 3 të VKM-së.

Tabela nr. 2

Pozicioni	Klasa e pagës (ishte)	Klasa e pagës (bëhet)	Shtesa për pozicion (ishte)	Shtesa për pozicion (bëhet)
Drejtor i Përgjithshëm	II-A	I-5	112,500	170,000
Drejtor Drejtorie	II-B	II-2	91,000	141,000
Përgjegjës	IIIA	III-2	80,300	105,000
Përgjegjës/K.Inspektor	IIIA/1	III-3	73,900	98,000
Specialist/Inspektor	IIIB	IV-2	63,000	80,000
Specialist	IVA	IV-3	56,000	70,000
Specialist	IV-B	IV-4	44,000	60,000

Për pikën 2. Miratimin e shtesës për vjetërsi në punë.

Shtesa për vjetërsi në punë, nga 2% për çdo vit deri në 25 vjet, e cila aktualisht llogaritet mbi pagën e grupit, bazuar në VKM-në nr. 503, datë 1.8.2024, do të jepet deri në 30 vjet dhe do të llogaritet mbi pagën e pozicionit, në masën si vijon:

- i. 0.6% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi shtesën për pozicion (paga e pozicionit);
- ii. 0.8% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi shtesën për pozicion (paga e pozicionit);
- iii. 1% pas çdo viti pune për 10 (dhjetë) vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi shtesën për pozicion (paga e pozicionit);

Duke qenë se kufijtë e pagave bazë për punonjësit administrativë në VKM-në nr. 503 datë 01.08.2024 nuk kanë ndryshime, në këtë projektvendim nuk pasqyrohet rritje.

Për sa i përket pagave të Policisë Bashkiake, Bashkia Vlorë i është drejtuar Ministrisë së Pushtetit Vendor për mënyrën e trajtimit me pagë të tyre. Në pritje të një përgjigje nga ana e Ministrisë, Bashkia Vlorë do të ruajë të njëjtin nivel page për këta punonjës.

Për sa më sipër, Bashkia Vlorë i drejtohet për miratim Këshillit Bashkiak me këtë Projektvendim "Për disa ndryshime në VKB nr. 92, datë 24.11.2023 "Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të Bashkisë, Institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2024" i ndryshuar.

Bashkëlidhur gjendet VKM nr. 503 datë 01.08.2024.

Ju faleminderit!

Konceptoi: L.Brinja



Konfirmoi: O.Durrolli



KRYETAR

Ermal Dredha

